

Drita Mamuti Fazlia, PhD¹

UDC:
355.356(100-622HATO:497.7),,2001”

**OPERACIONET E NATO-SË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
PAS KONFLIKTIT TË 2001**

**ОПЕРАЦИИТЕ НА НАТО ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
ПО КОНФЛИКТТОТ ОД 2001 ГОДИНА**

**NATO OPERATIONS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA
AFTER 2001 CONFLICT**

ABSTRACT

The topic of the paper is security of Macedonia before, during and after the 2001 conflict. NATO's intervention in ethnic conflict events in Macedonia was accomplished through mediation and various field operations to restore the country's stability and security situation. Indeed, the role of NATO has a special and very significance in the events of 2001, as the NATO found a compromise solution between the political parties. Thus, the 2001 conflict in the Republic of Macedonia succeeded in concluding for a short period of time the free intervention of the International Community, in the first instance of NATO's successful involvement, with the concretization of the Ohrid Framework Agreement. The Ohrid Framework Agreement, signed between parties to the conflict and the international community, was the basis for NATO to open a way for its involvement in the field and concrete intervention.

The North Atlantic Organization undertook three operations during the period August 2001 to March 2003 in the Republic of Macedonia. First, the “Essential Harvest” operation, a mission that led to the voluntary disarmament of the National Liberation Army (KLA) fighters

¹ Autorja është ligjëruese në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës, e-mail adresa: drita.fazlia@unite.edu.mk

in the territory of Macedonia. The second mission continued with the “Amber Fox” operation, which secured the protection of international observers in the field who followed the implementation of the peace plan. In the end, NATO undertook the Allied Harmony operation, launched in 2002 to provide consultative elements to the Macedonian Government in establishing stability throughout the country's territory, an operation that continued by the end of March 2003, when it was replaced by the European Union mission, “Koncordia”.

The security issue has been analyzed through concrete NATO operations pointing to the success or failure of their realization.

Hyrje

Organizata e Atlantikut të Veriut është një kontribuese aktive për paqen dhe sigurinë në skenën ndërkombëtare, përmes operacioneve të saja për menaxhimin e krizave, gatishmërinë e saj të veprojë si forcë pozitive për ndryshim dhe kapacitetin e saj për t'u përballur me sfidat e reja. Që nga operacioni i saj i parë në Ballkan, në vitet e hershme të '90-ta, ritmi dhe shumëllojshmëria e operacioneve të NATO-s janë rritur. Misionet dhe operacionet e NATO-s mbulojnë një spektër të gjerë të menaxhimit të krizave, duke u nisur prej misioneve paqeruajtëse dhe luftarake, trajnimet dhe përkrahjen logjistike, deri tek mbikëqyrja dhe ndihmat humanitare.

Është e domosdoshme të potencohet që NATO përveç që ka luajtur rol aktiv me operacionet e lartpërmendura pas konfliktit të 2001, ajo gjithashtu ka luajtur rol aktiv edhe gjatë konfliktit duke u kyçur edhe gjatë konfliktit. NATO u përfshi në parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit të armatosur në Maqedoni përgjatë vitit 2001 për disa arsye. Një prej arsyeve ishte se, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila gjatë viteve të nëntëdhjeta kishte parandaluar përhapjen e konflikteve në Kroaci, Bosnjë, ajo tash nuk kishte mundësin të kishte një rol në zgjidhjen e konfliktit në Maqedoni për shkak të bllokimit në Këshillin e Sigurimit si pasojë e vetos nga ana e Kinës.²

² OKB-ja kishte vendosur një forcë në Maqedoni në janar të vitit 1993, që ishte nën kujdesin e të ashtuquajturit operacioni UNPROFOR në Kroaci dhe në Bosnjë. Operacioni u vendos në Maqedoni, si pasojë e kërkesës nga qeveria e cila kishte frikë për një përshkallëzim të mëtejshëm të konfliktit të dhunshëm të Bosnjës dhe Kroacisë në Maqedoni. Në vitin 1995, Këshilli i Sigurimit zëvendëson UNPROFOR-in në Maqedoni me misionin UNPREDEP (Forcat e Kombeve të Bashkuara Parandaluese),

Bashkimi Evropian u angazhua shumë në procesin e ndërmjetësimit, por kësaj organizate i mungonte aftësia e plotë për vendosjen e një operacioni paqeruajtës në terren. Gjithashtu, edhe OSBE-ja u ballafaqua me të njëjtin problem të BE-së, kështu që NATO ishte i vetmi opsion i cili mund të kishte një rol kryesor në parandalimin e konfliktit të armatosur në vitin 2001 në Republikën e Maqedonisë. Operacioni nga ana e NATO-s erdhi nga kërkesa e shprehur e autoriteteve maqedonase dhe pas marrëveshjeve të dakorduara për arritjen e armëpushimit dhe ndërprerjen e armiqësive, NATO në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së ishte kompetente të kryente gjithë operacionin vetëm, pa pasur autorizimin e Këshillit të Sigurimit.³

1. Operacioni Essential Harvest/Task Force Harvest

Më 29 qershor 2001 NATO e miratoi planin operativ “Essential Harvest/Korrja e Domosdoshme”, Ky plan operativ si kusht për realizimin e tij e kishte vënien e dialogut politik mes palëve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë dhe do të respektohej armëpushimi. Ky plan ishte si rezultat e kërkesës së presidentit të R. Maqedonisë Boris Trajkovski.

Dy ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, më 15 gusht 2001, Këshilli i Veri-Atlantikut ka dhënë lejen dhe autorizimin e vetë për krijimin e një zyre qendrore për operacionet e NATO-s në Republikën e Maqedonisë. Më pas, ka vendosur të dërgoi 400 ushtarë⁴, të cilët kishin si detyrë të përgatisnin terrenin për vendosjen e forcave dhe të vlerësojnë situatën e sigurisë në atë terren. Çarmatimi i ushtarëve të UÇK-së është një pjesë kyçe e marrëveshjes të nënshkruar më 13 gusht midis politikaneve maqedonas dhe atyre shqiptarë për t'i dhënë fund konfliktit.

por mandati i këtij misioni mbeti në thelb i njëjti dhe shtrihej në intervale të rregullta. Në shkurt të vitit 1999 megjithatë, zgjatja e misionit ishte bllokuar nga ana e Kinës, e cila përmes përdorimit të vetos në Këshillin e Sigurimit. Vendimi i Kinës vinte si pasojë për njohjen e Tajvanit nga ana e Maqedonisë, dhe si një kundërmasë ajo bllokoi zgjerimin e misionit UNPREDEP, duke sjellë ndërprerjen e tij. Për më shumë shih: SC Res. 842 (1993), <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N93/36/0/82/IMG/N9336082.pdf?OpenElement> dhe SC Res.983 (1995), <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N95/094/33/PDF/N9509433.pdf?OpenElement>

³ A.J. Bellamy, P. Williams, S. Griffin, *Understanding Peacekeeping*, 2004, f. 265-267.

⁴ Këto ishin ushtarë francez, britanikë dhe çekë nën komandën e brigadierit britanik Barney White-Spunner.

Operacioni “Korrja e Domosdoshme” zyrtarisht u aprovua më 22 gusht të vitit 2001. Kjo Task Force, e cila do të zgjaste 30 ditë⁵, kishte si detyrë mbledhjen e armëve dhe municioneve të dorëzuara vullnetarisht nga ana e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), në mënyrë që të instauron një besim i ndërsjellë për implementimin e proceseve të paqes dhe sigurisë.

Qëllimi i këtij misioni të NATO-s ishin mbledhja e armëve dhe municioneve, sistematizimi i vetë tyre në vende të veçanta të mbledhjes, ku më vonë edhe do të shkatërroheshin.

Udhëheqësi i operacionit “Korrja e domosdoshme”, brigadieri anglez Barney White-Spunner para nisjes për në Shkup më 16 gusht 2001, do të deklarojë se në të gjitha operacionet ushtarake ka rrezik, por këtë radhë ne jemi të ftuar tha ai, duke besuar se ushtarët e UÇK-së do të qëndrojnë pas marrëveshjes së nënshkruar dhe to të dorëzojnë armatimin vullnetarisht.⁶ Të gjithë shtetet anëtare të NATO-s kanë dhënë kontributin e tyre me ushtarë dhe me mjete për të arritur suksesin e këtij misioni. Franca është shprehur se do të dërgojë 530 ushtarë, ndërsa kontingenti më i madh është ai i Britanisë së Madhe me një numër prej 1200 ushtarë. Në veçanti, trupat të caktuara për operacioni “Essential Harvest” përfshinin:

Njësitë e mëdha kombëtare

Belgjika: 1 kompani ajrore

Kanada: Kompania 1 këmbësorisë

Republika Çeke: 1 kompani këmbësorie

Franca: grupi i parë i këmbësorisë

Gjermania: 2 kompani këmbësorie

Greqia: 1 grup i këmbësorisë

Italia: 1 grup i këmbësorisë

⁵ Prej 27 gusht deri më 27 shtator 2001.

⁶ Gazeta “The Daily Telegraph”, 17 gusht 2001, Brigadier hopes for successful Harvest.

Holanda: 1 kompani këmbësorie

Spanja: Kompania 1 këmbësorisë

Turqia: Kompania 1 këmbësorisë

Britania e Madhe: 1 grup i këmbësorisë dhe selinë e brigadës

“Ne nuk jemi në biznesin e punës të detektivit, roli që neve na është kërkuar për të luajtur vjen nga kërkesa e vet qeverisë maqedonase për mbledhjen e armëve nga grupet etnike shqiptare të cilët kanë thënë se do të çarmatosen...kjo është ajo që ne do të bëjmë, jo më shumë, jo më pak.” tha, Lord Robertson, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.⁷ Nga kjo deklaratë mund të shihet bashkëpunimi i përfaqësuesve të NATO – së, të Republikës së Maqedonisë dhe përfaqësuesve të UÇK-së, fakt që i shtonte shpresat për realizimin e suksesshëm të këtij operacioni. Por edhe përkundër marrëveshjes paraprake parashtroheshin shumë dilema për suksesin e këtij operacioni pas mbarimit të tij, dilemë së cilës iu përgjigj zëdhënësi i NATO-s, Yves Brodeur (Iv Broder), i-u është përgjigjur spekulimeve në lidhje me periudhën menjëherë pas përfundimit të operacionit “Korrja e Domsdoshme” duke thënë: “Pasi operacioni Essential Harvest ka përfunduar me sukses detyrën e saj, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë do të hyjë në një fazë konsolidimi. Do ti takojë qeverisë së ish Republikës së Maqedonisë të vendos se si ajo dëshiron të vazhdoj përpara, duke përfitur nga ajo që ne besojmë se do të jetë një mjedis premtues për stabilitetin dhe paqen si rezultat i operacionit Essential Harvest.⁸ “Barney White-Spanner⁹, tha se guerilasit shqiptarë gjatë tridhjetë ditëve të kaluara dorëzuan vullnetarisht 3875 armë të kalibrave të ndryshëm, përfshirë këtu dhe katër tanke dhe autoblanda si dhe 17 sisteme të mbrojtjes ajrore dhe rreth 400 mijë municione të llojeve të ndryshme, përfshirë këtu edhe material shpërthyes. Mes tjerash, oficeri Spaner konstatoi: “Asnjë organizatë nuk do të

⁷ <http://www.irishtimes.com/news/nato-begins-arms-operation-in-macedonia-1.323862> “NATO begins arms operations in Macedonia”, Thursday, August 23, 2001, 01:00. Deklarata e dhënë më 5 shtator 2001

⁸ <http://www.nato.int> NATO Update, week of 3-9 September 2001.

⁹ Brigadieri i lartë i misionit.

dorëzonte caq shumë armë të cilësisë caq të lartë nëse nuk do t'i përkushtohet tërësisht paqes.”¹⁰

Sipas marrëveshjes armatimit ushtarët e UÇK-së duhet t-ia dorëzojnë të ushtarët e NATO-s në mënyrë vullnetare nëpër pikat ku ata i kishin vendosur. Gazetarët Julius Strauss nga Nikushtaku dhe gazetari Michael Smith nga Shkupi të gazetës “The Daily Telegraph”, në 28 gusht 2001, do të raportojnë për misionin e grumbullimit të armëve nga UÇK-ja. Përmendet aksioni në fshatit Radushë të Shkupit, ku Komandanti i UÇK-së Mësuesi, do të dorëzojë tanket T-55 që i kishin në dispozicion Brigada e tij, tanke të cilët ushtarët e UÇK-së arritën ti kapin nga Armata maqedonase gjatë luftimeve, gjithashtu ai dorëzoi raketa Antiajrore SAM-7, RPG7 dhe mitralozë të rëndë.¹¹

Detyrat kryesore të ndërmarra nga fundi i qershorit deri në fund të shtatorit të vitit 2001 ishin, pra, grumbullimi, mbledhja e armëve dhe municioneve, të dorëzuara në vend vullnetarisht nga ana e kryengritësve shqiptarë, si dhe si hap përfundimtar transportimin dhe asgjësimin e këtyre armëve. Këto në tabelë janë të raportuara numri i armëve të asgjësuara në Operacionin Essential Harvest:

Lloji i armëve Sasia

Mitraloza 483

Pushkë sulmi 3,210

Armë mbështetëse 161

Sisteme të mbrojtjes ajrore 17

Tanke 4

Municione dhe materiale shpërthyes 397,625

¹⁰ <http://www.bbc.co.uk>

¹¹ Gazeta “The Daily Telegraph”, 24 gusht 2001, Albanian rebels begin giving weapons.

2. Amber Fox

Pas miratimit të planit operativ më 26 shtator 2001, Këshilli i Atlantikut të Veriut ka rënë dakord për të nxjerrë një direktiv ekzekutimi përmes të cilës autorizon Gjeneralin Josef Ralston, për dhënien e urdhrat për aktivizimin e operacionit “Amber Fox”.¹²

Ky mision zyrtarisht filloi më 27 shtator 2001 me një mandat fillimisht tre mujorë, i cili mandej u shty deri më 15 dhjetor të vitit 2002.

Operacioni “Amber Fox” ka pasur si qëllim mbështetjen e vëzhguesve ndërkombëtar të Unioni Evropian dhe të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE/OSBE), të cilët mbikëqyrnin zbatimin e planit të paqes në ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe përcjelljen e refugjatëve për kthim në shtëpitë e tyre. Detyrat e sigurisë do iu besuan forcave maqedonase të policisë, të cilat tashmë duhet të reformoheshin në bazë të përbërjes aktuale etnike të vendit.

Udhëheqja e këtij operacioni u realizua nga ana e Gjermanisë, e cila kishte në dispozicion 1000 ushtarë. Task Force Fox është emri me të cilin njiheshin trupat e destinuar për misionet dhe përbëhej nga rreth 700 trupa nga vendet anëtare të NATO-s, e cila erdhi në përfundim të rreth 300 trupave tashmë të stacionuara në terren. Operacionet janë kryer nga Gjenerali holandez J. H. de Jonge, i cili kishte si detyrë të bëjë raportimin e vazhdueshëm të progresit të misionit Gjeneralit të Përgjithshëm Gaetano Cigna, që ishte Përfaqësuesi i lartë ushtarak i NATO-s në Republikën e Maqedonisë. Siç thuhet më lartë, kjo Task Force përbëhet nga 700 ushtarë të ndarë në tre njësi:

–Extraction Force (Forca Nxjerrëse), e cila ishte e përbërë nga 3 kompani, një italiane, një franceze dhe një gjermane, që formonin gjithsej 100 ushtarë çdonjëra;

–Military Liaison Team (Ekipi Ndërlidhës Ushtarak), i cili ishte ngarkuar me detyrën e shoqërimit të vëzhguesve ndërkombëtarë në kryerjen e punës së tyre të monitorimit. Grupet vëzhguese udhëtonin vazhdimisht të shoqëruar nga katër ushtarë të ndarë në dy automjete, për një total prej 135 ushtarëve nga Gjermania, Franca, Portugalia, Polonia, Greqia dhe Spanja;

–Një ekip danez, që ishte në krye të vëzhgimit për fushat në të cilat do iu drejtoheshin vëzhguesit ndërkombëtar.

¹² Operation Amber Fox (Task Force Fox) 27 September 2001.

<http://www.bits.de/public/documents/mazedonien/home.htm>

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, mbështeti përpjekjet e NATO-s, me kalimin e Rezolutës 1371 më 26 shtator 2001. Edhe pse paqeruajtësit e NATO-s kishin si detyrë mbështetjen dhe sigurinë e vëzhguesve ndërkombëtar, ato mundet të vepronin vetëm në qoftë se kjo vinte si kërkesë e qeverisë së Maqedonisë,¹³ e cila kishte rolin kryesorë në mbajtjen e sigurisë shtetërore.

Duke pasur parasysh afrimin e kohës së zgjedhjeve, Task Force Amber u përqendrua vetëm mbi ish-zonat e krizës në veriperëndim të vendit, që ishte edhe zona e punës e vëzhguesve ndërkombëtar. Megjithatë, ky operacion ishte i autorizuar të vepronte përgjatë gjithë territorit të Maqedonisë. Ky operacion i dha mbështetje vëzhguesve, përmes atyre që ishin të njohur si ekipet në terren ndërlidhëse dhe mbajti një kontakt ngushtë të lidhur me selinë e misioneve vëzhguese dhe me autoritetet qendrore të shtetit. Prania e ekipeve në terren i dha, gjithashtu, një vizibilitet komunitetit ndërkombëtar, i cili tashmë ishte i parë në sy të mirë nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Si ndodhi për operacioni “Essential Harvest” edhe operacioni “Amber Fox” kishte një shtab strategjik dhe një seli operative. Selia e Amber Fox dhe ajo e KFOR-it, që gjendeshin në Maqedoni, u shkrinë në prill 2002 për të formuar Shtabin e NATO-s në Shkup (NATO Headquarters Skopje). Operacioni Amber Fox përfundoi më 15 dhjetor të vitit 2002.¹⁴

3. Allied Harmony

Nga fundi i vitit 2002, operacioni Amber Fox kishte prodhuar rezultate tejet të mira dhe të kënaqshme, dhe situata në Republikën e Maqedonisë ecte kah normalizimi në mënyrë të përshpejtuar. Për këto arsye, që kishin çuar në një përmirësim të dukshëm të kushteve të sigurisë ndër të cilët po vepronin vëzhguesit ndërkombëtar, Këshilli i Atlantikut Verior vuri në dukje në se nuk kishte më nevojë për një operacion të veçantë në territor dhe kështu nga 15 dhjetori i vitit 2002 do të vendosej një mision i ri.

Këshilli pajtohet se ka një kërkesë për një follow të pranisë ushtarake ndërkombëtare në vend. Shtyrja e pranisë së tyre në territor ishte

¹³ Terry M. Mays, *Historical Dictionaries of Multinational Peacekeeping*, Scarecrow Press, Inc. Lanham, Toronte, Plymouth, UK, 2011.

¹⁴ <http://www.nato.int/fyrom/tff/home.htm> Operation Amber Fox, 27 September 2001-15 December 2002.

një mënyrë që rreziqet e destabilizimit të minimizohen. Prania e vazhdueshme e NATO-s pas 15 dhjetorit do të jetë e dyfishtë: elementet e saj operacionale do të ofrojnë mbështetje për vëzhguesit ndërkombëtar dhe elementet e saj këshillimore do të ndihmojnë qeverinë në marrjen e pronësisë së sigurisë në të gjithë vendin¹⁵. Misioni i ri do të jetë dukshëm më i vogël në numër me 400 ushtarë të NATO-s dhe do të quhet Allied Harmony.

Komanda ekzekutive e këtij misioni do t'i besohej selisë kryesore të NATO-s në Shkup (NATO HeadQuarter Skopje). Operacioni Allied Harmony do të ndihmojë qeverinë e Republikës së Maqedonisë në marrjen e pronësisë së sigurisë në të gjithë vendin. Ky mision do të ketë aftësinë për të komunikuar me autoritetet lokale në ish-rajonin e krizës dhe do të kontribuojë në mbështetjen e vëzhguesve ndërkombëtar, duke pranuar se autoritetet lokale kanë përgjegjësinë primare në këtë drejtim.

Operacioni u vazhdua deri më 31 mars të vitit 2003, kur u zëvendësua në detyrat e saja nga misioni i parë militar i Unionit Evropian i njohur si Operacioni "Koncordia". Ky mision ishte i pari i këtij lloji në historinë e komunitetit evropian, dhe përfaqësonte një hap të madh të zhvillimit të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së përgjithshme për vetë Unionin.

"Duke marrë përsipër misionin e parë ushtarak, BE-ja tregon se projekti i saj për një politikë të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive i ka ardhur koha. Duke u bazuar në lidhjet e reja institucionale me NATO-n, Bashkimi Evropian tani mundet në mënyrë më efektive të mbajë gamën e plotë të mjeteve politike, ekonomike dhe ushtarake." Këto janë fjalët e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Lord Robertson.¹⁶

Përfundimi i operacionit Allied Harmony më 31 mars është marrë nga vendimi i Këshilli i Atlantikut të Veriut.¹⁷ Dorëzimi është bërë i mundur pas marrëveshjeve të arritura nga ana e Bashkimit Evropian dhe

¹⁵ Nato to continue supporting The Former Yugoslav Republic of Macedonia, 29 November 2002, NATO Press Releases. <http://www.nato.int/docu/pr/2002/p02-131e.htm>

¹⁶ <http://www.nato.int/docu/update/2003/03-march/e0331a.htm> Operation Allied Harmony ends, March 2003.

¹⁷ Këshilli i Atlantikut të Veriut është njësi vendimmarrëse me rëndësi vendimtare për Aleancën. Ky Këshill është njësi politike që përbëhet nga përfaqësues të të gjithë shteteve anëtare.

CENTRUM 7

NATO-s për qasje nga ana e BE-së në aktivitetet kolektive dhe aftësitë e NATO-s për operacionet e drejtuara nga Bashkimi Evropian.¹⁸

Pas përfundimit të tre operacioneve të lartpërmendura ia vlen që të analizohet përqindja e vrasjeve në Republikën e Maqedonisë në periudhë prej 20 viteve për të parë nevojën dhe rezultatin nga operacionet konkrete. Kjo më mirë shihet nga të dhënat zyrtare të RM, marrë nga Enti statistikor i RM në njoftimin e shpallur më 26.06.2015.

Viti	%
1994	5,2
1995	5,2
1996	7,6
1997	6,8
1998	6,5
1999	6,6
2000	8,3
2001	17,8
2002	9,3
2003	10,5
2004	7,9
2005	8,9
2006	8,1
2007	6,5

¹⁸ <http://www.nato.int/docu/update/2003/03-march/e0331a.htm> Operation Allied Harmony ends.

CENTRUM 7

2008	6,7
2009	4,7
2010	7,5
2011	5,5
2012	5,8
2013	3,3
2014	7,1

Nga tabela mund të konkludojmë që në periudhën para konfliktit të 2001 në RM ka pasur përqindje më të ulët të vrasjeve, ndërsa në periudhën gjatë dhe pas konflikti kjo përqindje dukshëm është rritur dhe pas operacioneve të NATO-së ai sërisht ka rënë diku në përqindje të para konfliktit. D.m.th. operacionet kanë qenë më se të nevojshme dhe rezultati i tyre ka qenë i dukshëm.

CONCLUSION

NATO's success was a combination of diplomatic means through the sending of special representatives, the establishment of dialogue between the two sides, mediation with them to find a satisfactory solution and final act with the signing of the Ohrid Framework Agreement, and military means, which did not imply the use of military power and violence, but the deployment through troops in various peace-return missions and stability in the state for the launch of constitutional reforms. The 2001 conflict in Macedonia ended by signing a political compromise document between the parties, known as the Ohrid Framework Agreement which not only interrupted the conflict but also determined the direction of future social development and politics of Macedonia, through the reforms that would be made in the Constitution and in the legislation.

From NATO's field operations and the Alliance's commitment to resolving the conflict, we can see that the intervention and the role of NATO was extremely important during the 2001 conflict in Macedonia,

a role associated with achievements which were reflected in a new chapter in the role of the North Atlantic Organization versus the state of Macedonia.

If we see the realization of NATO operations in Macedonia after the 2001 conflict, we can conclude that they have been successfully implemented and have helped the country to put peace and security in line with the circumstances of the country. Also an additional tool for the success and assistance of NATO operations is the statistical data that indicate that in the period of conflict there was an increase in the number of gun killings, whereas in the post-conflict period the number of murders was significantly reduced as a result of recruitment of weapons. Another important argument connecting the problem of weapons to the Republic of Macedonia is the level of crime within the state territory.

Literatura e konsultuar

- Terry M. Mays, Historical Dictionaries of Multinational Peace-keeping, Scarecrow Press, Inc. Lanham, Toronte, Plymouth, UK, 2011.
- A.J. Bellamy, P. Williams, S. Griffin, Understanding Peace-keeping, 2004
- Julie Kim, Macedonia: Country Background and Recent Conflict, CRS Report for Congress, Updated March 28, 2002,
- ZIDAS DASKALOVSKI THE MACEDONIAN CONFLICT OF 2001: BETWEEN SUCCESSFUL DIPLOMACY, RHETORIC AND TERROR, Studies in Post-Communism Occasional Paper no. 7 (2004) Centre for Post-Communist Studies St. Francis Xavier University,
- Drita M. Fazlia, Organizatat ndërkombëtare, Arberia Dizajn, 2014
- NEWS RELEASE, Year LIII, No: 2.1.15.22, 26.06.2015, Enti shtetëror statistikor i RM
- Gazeta "The Daily Telegraph", 17 gusht 2001,
- Gazeta "The Daily Telegraph", 24 gusht 2001,
- Nato to continue supporting The Former Yugoslav Republic of Macedonia, 29 November 2002, NATO Press Releases